

VENDIM
Nr. 162, datë 1.3.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 99 HA NË OBJEKTIN “MAÇ-PEROLLAJ”, TË QARKUT
TË KUKËSIT, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “BLERIMI KOSTURR 2010” SHPK
PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË KROMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore publike prej 99 ha, pjesë e ngastrave 1b, 2, 3b dhe 4b në objektin “Maç-Perollaj”, të ekonomisë pyjore “Krumë”, në Qarkun e Kukësit, që do të përdoret nga shoqëria “Blerimi Kosturr 2010”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të kromit të hiqet nga fondi pyjor e kullor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore dhe kullimore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullimore, në sipërfaqen objekt minerar, paguhet nga shoqëria “Blerimi Kosturr 2010” sh.p.k. në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Blerimi Kosturr 2010” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim sipas kushteve të lejeve mjedisore dhe, brenda dy viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 7 ha dhe të përmirësojë 184 ha sipërfaqe kullimore në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore e kullimore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore dhe kullimore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit nga shoqëria “Blerimi Kosturr 2010” sh.p.k., sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Blerimi Kosturr 2010” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "BLERIMI KOSTURR 2010" sh.p.k. në qarkun e KUKËSIT
NË OBJEKTIN ' MAC - PEROLLAJ', Has.**

QARKU KUKËS

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosor e</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Perdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
KU 26 00	Krume	1b	kullote	ministra mjedisit	5
KU 26 00	Krume	2	kullote	ministra mjedisit	81
KU 26 00	Krume	3b	cungishte	njqv	7
KU 26 00	Krume	4b	kullote	ministra mjedisit	6
GJITHSEJ					99.00

K-34-65-B-a & K-34-65-B-c
EKONOMIA PYJORE "KRUME"
SUBJEKTI "Blerimi Kosturr 2010" Sh.p.k
OBJEKTI "Maç-Perollaj", RRETHI HAS

SH 1:10000



